



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Instituti për Planifikim Hapësinor

Raport nga Vizita studimore



**Planifikimi dhe Menaxhimi
i Parqeve Nacionale dhe
Natyrore në Bullgari**

08-13 Tetor 2007



12.10.2007

**Raport nga Vizita studimore:
Planifikimi dhe Menaxhimi i Parqeve Nacionale dhe Natyrore
në Bullgari
08-13 Tetor 2007**

Pjesëmarrës në Vizitë:

Muzafer Luma Agjencia e Pylltarisë së Kosovës
Miftar Lokaj
Naim Ramadani
Bekim Topalli

Oazim Kukalaj MBPZHR – Sekretar permanent
Hajrush Kurtaj

Iljaz Nesho Administrata e Parkut Nacional
Xhavit Mala

Elez Krasniqi MMPH –
Fadil Bajraktari Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit
Tone Gashi

Luan Nushi MMPH –
Shpend Agaj Instituti për Planifikim Hapësinor
Festa Nixha Nela

Ergin Hajredini Projekti për
Jeton Perquku Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve



Organizuar nga:

PM Group, projekti për menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve, të financuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) dhe që është duke u implementuar nga Konsorciumi Ndërkombëtar i udhëhequr nga Project Management Group (Irlanda), 2007-2009

Qëllimi i vizitës:

Njohja me planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të parqeve nacionale (PN -Pirin) dhe parqeve natyrore (Parku Natyror - Vitosha).

Hartues të raportit:

Pjesëmarrësit nga MMPH – Instituti për Planifikim Hapësinor

08 Tetor 2007 – Dita e parë

Nisja nga Prishtina në ora 9h, arritja në Sofje 19h.

09 Tetor 2007 – Dita e dytë - Sofie

Vizitë Ministrisë së Bujqësisë, gjegjësisht Departamenti i Pylltarisë – zonave të mbrojtura.

Bordi nacional i pyjeve, sot quhet Agjencia e pyjeve shtetërore

Takimi ishte i organizuar në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë. Pritja u bë nga z. Jorgi Tincev zyrtar për Zona të Mbrojtura me disa kolegë tjerë. U elaborua në pika të shkurtra statusi i punëve të Departamentit si dhe ai i Bordit Nacional të Pyjeve i cili sot quhet Agjencia Shtetërore e Pyjeve.

Paralelisht me këtë takim, një grup i delegacionit (sekretari permanent i MBPZHR, drejtori i APK-së dhe drejtori i IPH-së) ka marrë pjesë në takimin e nivelit të lartë me nikoqir zv. Ministrin e Ministrisë së Bujqësisë të Bullgarisë. Në takim, nga zv. Ministri u njoftuam me strukturën e organizimit dhe përgjegjësitë e Ministrisë dhe përmes pyetjeve tona shtjelluam disa problematika që janë të lidhura me situatën në Kosovë.



Agjencia Shtetërore e Pyjeve është divizion i Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve, përfshinë departamentet që qeverisin, menaxhojnë dhe mbrojnë pyjet, tokën dhe ujërat. Menaxhimi dhe administrimi në këtë rast i Parqeve Natyrore që deri më sot janë dhjetë (10) bëhet nga ky trup. Ky Agjencion bën përkrahje aktive përmes udhëzimeve për aktivitetet përbrenda territorit të Parkut.

Në vazhdim është bërë prezantimi nga një ekspert i mbrojtjes së Natyrës lidhur me "Planifikimin dhe Menaxhimin në Zonat e Mbrojtura". Ajo që vlen të ceket është se në Bullgari ekzistojnë 6 kategori të Zonave të Mbrojtura:

- I. Rezervatet / Rezerve
- II. Parku Nacional
- III. Monument natyror – jo të gjalla
- IV. Rezervatet e mirëmbajtura – flora dhe fauna me habitate të tyre
- V. Park Natyror
- VI. Peisazhe të mbrojtura (peisazh karakteristik me florë dhe faunë të veçantë)

Duke marrë parasysh qëllimin e udhëtimit dhe agjendën e vizitave në terren, ishim më tepër të interesuar të dimë mbi atë se kush menaxhon dhe administron me Parqe nacionale?

Ministria e Mjedisit dhe e Ujërave ishte përgjegjëse për menaxhimin e këtyre kategorive:

- I. Rezervatet
- II. Parqet Nacionale
- III. Rezervatet e mirëmbajtura


Ndërsa Agjencioni shtetëror i pyjeve menaxhon me:

- IV. Monumente natyrore
- V. Parqe Natyrore
- VI. Peisazhe të mbrojtura

Bullgaria ka tri Parqe Nacionale – Pirin, Rila dhe Central Ballkan. Sipërfaqja e tyre është 193.049 ha dhe përbën më tepër se 1/3 e të gjitha zonave të mbrojtura në Bullgari. Parqet nacionale i takojnë shtetit dhe janë prona publike. Ato janë të menaxhuara dhe administruara nga drejtoritë, që operojnë nën Ministrinë e Mjedisit dhe Ujërave. Parqet nacionale dhe Parqet Natyrore disponojnë me Plane Menaxhuese të cilave u epet leja për hartim sipas marrëveshjes së kushteve dhe

rregullave të aktit për Zonat e mbrojtura, bartës i së cilës është Ministria e Mjedisit dhe Ujërave. Përbrenda Parkut si atij Nacional dhe Natyror janë zonat (kategoritë):


- I. Rezervatet dhe rezervatet e mirëmbajtura;
- II. Zonat turistike;
- III. Zonat me shtëpiza (baraka), qendrat administrative për rregulla dhe përkrahje parqeve dhe paisjet sportive;
- IV. Zonat tjera varësisht nga rrethanat specifike në parqe.



Parqet Pirini, Rila dhe Central Ballkani janë ndër zonat mbrojtëse më të mëdha në Evropë. Të identifikuar në kategorinë e II të zonave të mbrojtura sipas IUCN-së, parqet janë të menaxhuara sipas principeve dhe rregullave të konservimit. Planet menaxhuese për Rilën dhe Central Ballkanin janë të parat dokumente menaxhuese moderne dhe konservuese të llojeve të tyre në Ballkan.

Përveç Parqeve Nacionale që janë në kategorinë e dytë, sipas kategorizimit në Bullgari ekzistojnë Parqet Natyrore (10) që janë në kategorinë e pestë dhe që pesë nga ato janë të miratuara ndërsa të tjerat janë në proces. Agjencia Shtetërore e Pyjeve administron dhe menaxhon me pyjet e kësaj kategorie të parqeve. Menaxhimi dhe administrimi bëhet nga Drejtoritë përkatëse, bëjnë implementimin e planeve menaxhuese, të cilat hartohen për 10 vjet. Detyrë tjetër është konservimi biologjik dhe peisazhor i diversitetit, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe historike, edukimi dhe vetëdijesimi për mjedisin, zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së parkut, zhvillimi i produkteve turistike, hulumtime të ndryshme shkencore dhe mirëmbajtjen e databazës së parkut

Mësimet e mësuara nga prezantuesit ishin se involvimi i pjesëmarrësve është mjaft i vështirë, koncenzi si i tillë nuk mund të mirët me mend, pra të gjitha këto janë më tepër "dëshira për të arritur" qëllimin.



Vizitë Parkut Natyror Vitosha

Parku Natyror Vitosha është shpallur më 1934, ka një sipërfaqe prej 27.000 ha (95.5% e të gjitha maleve të Vitoshës). Në vitin 2005 është miratuar Plani menaxhues për këtë park, i cili në vete i ka dy rezervate të mbrojtura. Maja më e lartë është Maja e Zezë me 2290m'. Numri i vizitorëve brenda ditës që e vizitojnë këtë park është shumë i madh.



Drejtorja e Parkut natyror Vitosha është një degë e Agjencisë Shtetërore të Pyjeve përbrenda Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve e cila menaxhon dhe administron me parkun, kontrollon aktivitetet pyjore, planifikimin dhe monitorimin e hulumtimeve në park, VNM-në e faktorit natyror dhe njerëzor, planifikimin dhe kontrollimin e itinerarit turistik, organizimin dhe implementimin e aktiviteteve rekreative etj. Në këtë drejtori punojnë 16 profesionistë të lëmive të ndryshme.

“Qendra informative e vizitorëve “ në Parkun Natyror Vitosha

E mbështetur nga Ministria e Mjedisit dhe e Ujërave, e financuar nga USAID-i. Kjo qendër është hapur në 1998. Në brendi të objektit ishte hapësira për ekspozitë, qasja adekuate e informacioneve për turistë. Mundësia e shikimit të video koleksioneve dhe një bibliotekë solide me mundësi qasjeje nga secili vizitor. Kjo qendër mundësonte organizimin e festimeve të ditëve natyrore, ekspozitave, garave, bashkëpunimin me kopshte, shkolla, OJO etj. që të vetëdijësojë me mësim dhe aktivitete edukative mjedisore. Në këtë qendër gjendej edhe pingu vrojtues nga i cili mund të shiheshin pamje të bukura të qytetit të Sofjes.



11 Tetor 2007 – Dita e katërt - Bansko

Vizitë drejtorisë së Parkut Nacional Pirin në Bansko



Takimi në drejtori ishte shumë mikpritës dhe i afërt. Nga zv.drejtori i kësaj drejtorie u prezantua në pika të shkurta Parku Pirin, i shpallur park nacional më 1998, sipërfaqja e të cilit është 43.600 ha dhe përfshin pjesët e komunave si Razlog, Bansko, Gotse Delchev, Sandanski, Stroumyani, Kresna dhe Simitli. Ministria e Mjedisit dhe Ujrave menaxhon me Parkun, e cila është e ndarë në pesë (5) rajone të cilat kanë nga një zyre në kuadër të parkut ndërkaq drejtoria gjendet në Bansko – qytetë turistike shumë atraktive për vizitorë dhe turistë si në sezonin e verës por veçanërisht për sezonin dimëror. Pika më e lartë e parkut është 2.914 m' ka 180 liqene gjithsej dhe ka dy rezervate.

Plani i Menaxhimit të PN Pirin është aprovuar më 2004, ndihmesë në hartimin e këtij plani ishte Aagjencia Zvicrane – Intercooperation.



Drejtorija e parkut është ajo që menaxhon me strukturën organizative e parkut dhe e cila ka në vete tre sektorë:

1. Sek. Menaxhimi dhe kontrollimi i pyjeve (rojet e pyjeve);
2. Sek. Njësia e ekspertëve (florë, faunë...);
3. Sek. Administrata

Kategorizimi i zonave brenda parkut Pirin:

- Zonë e rezervatit ~ 15%
- Zonë me ndikim të kufizuar njerëzor ~ 20%
- Zonë për mbrojtje të ekosistemit pyjor dhe rekreacion ~ 50%
- Zonë për shfrytëzim të qëndrueshëm të territoreve të hapura dhe rekreacion;
- Zonë turistike;
- Zonë ndërtimore dhe shërbyese.



12 Tetor 2007 – Dita e pestë

Vizitë Parkut Nacional Pirin

Si pikë e parë referuese ka qenë zyra në afërsi të Banskos, prej nga më pastaj shkuam në një rezervat në të cilin, sipas përgjegjësve nuk lejohet të ndërmirët kurrfarë intervenimi ("si e ka falë nëna natyrë" pa ndërhyrje).



Ajo çfarë na bëri përshtypje gjatë vizitës është vendosja e simboleve në pjesë të nevojshme në Park, shembull shumë i mirë që një gjë të aplikohet në Parkun Nacional "Mali Sharr".



Në parqe nacionale nuk ka banim në brendi të tyre, poashtu nuk lejohet prerja e pyjeve. Gjatë vizitës që i bëmë parkut shkuam edhe në pjesën e terreneve të skijimit, dhe aty pamë prerjet që i janë bërë parkut për rregullimin e terreneve të skijimit. Këto prerje janë bërë para se të shpallej kjo zonë Park Nacional, në të kundërtën në bazë të rregulloreve në fuqi kjo gjë nuk do të lejohej.



Në vazhdim e vizituam një dru shumë të vjetër por shumë tërheqës për vizitorë. Arritja te druri në fjalë ishte jo aq e lehtë, prandaj është bërë një projekt përmes së cilit me disa shkallë druri janë evituar rreziqet e mundshme (druri në fjalë ishte i vjetër përafërsisht 1200 v. dhe sipas gojëdhënave, "përqaftimi" i tij ishte mundësi për plotësimin e dëshirave).



Është vizituar në vazhdim një fshat i ashtuquajtur "Fshati Ekologjik", me prodhime ekologjike – në të cilin ishte i ndërtuar një restorant ekskluziv i cili në mënyrë të vetë kishte vetëm ushqim pa pesticide.



13 Tetor 2007 – Dita e gjashtë - Blagojevgrad

Vizitë fshatit malor Vllahi

Mënyra e implementimit të projekteve ndërkombëtare për mbrojtjen e kafshëve vendore të buta dhe të egra.



Vllahi është fshat malor, në afërsi të Parkut Nacional Pirin, me një histori e cila dëshmon për aktivitete të shumta kundër rezhimit komunist. Ky ishte edhe fakti që fshati në fjalë në periudha të ndryshme i ishte nënshtruar presionit të qeverive të atëhershme komuniste. Fshat me një konfiguracion shumë interesant i cili dikur kishte afër 1000 banorë dhe që sot për arsyt e përmendura jetojnë vetëm 6 banorë.

Sot, dëshirohet që në këtë vend me anë të projekteve lidhur me mbarështimin e deles, kalit dhe qenit të rajonit Karakachan dhe me projekte për kafshë të egra, për mbrojtjen e tyre, si projekti për mbrojtjen e Ariut dhe Ujkut të kësaj ane, janë mënyra që kjo anë apo më mirë të themi këtij fshati t'i kthehet jeta që e ka pas dikur.

Për projektin e mbarështimit të kafshëve shtëpiake është elaboruar në pika të shkurta përgjigjja në pyetjen "Pse të kujdesemi për shumimin tradicional të këtyre kafshëve, pse janë aq të vlefshme, pse duhet të mbrohen pra ajo e fundit pse të investohet në këtë projekt?"

Kafshët e rralla Karakachane janë të parat dhe më të vjetrat kafshë shtëpiake në Evropë. Këto lloje kafshësh janë me vitalitet të lartë me një përshtatshmëri të mrekullueshme në kushte të ndryshme jetësore, me imunitet të lartë, trup të fortë me proporcione të mira, temperament vital dhe të qëndrueshëm. Delja, kali dhe qeni gjithsesi duhet ruajtur për qëllime të hulumtimit për imunologji, mënyrën e të ushqyerit, riprodhimit etj. Kultivimi i këtyre kafshëve do të jetë me rëndësi të madhe në të ardhmen. Ata kanë qenë dhe do të jenë unik për specifikat që i kanë.

Delja Karakachane është rezistente në sëmundje dhe e aftë të mbijetoj në terrene dhe kushte të vështira. Është adaptive për udhëtime të gjata në shtigjet e larta të maleve. Leshi i tyre është përdorur në zëjtari për prodhime të punimeve tradicionale.



Kali Karakachan është ende i pazëvendësueshëm, është përdorur për bartje të drunjëve, pa bërë dame në ekosistem të pyjeve. Këta kuaj kanë karakter të fortë dhe janë shumë të përshtatshëm për kalërim dhe rekreim. Ata janë shumë të lirë për pronarët e tyre sepse kullosin tanë vitin pa kërkesa që të mbyllen në hapësira më të ngrohta gjatë dimrit.

Qeni Karakachan gjithmonë ka qenë shumë i përshtatshëm për mbrojtje kundër grabitqarëve. Këta qenë ende e vërtetojnë aftësinë e tyre të punës së pakundërshtueshme në kontrast me disa lloje të qenve Evropian. Përveç këtyre, ata janë të devotshëm ndaj pronarit të tyre.

Ariu i murrmë dhe ujku - Karakteristikë e Parkut Pirini është edhe ekzistenca e kafshëve të egra të cilat sipas ekspertëve, në mungesë të trajtimit adekuat numri i tyre është duke u zvogëluar. Një gjë e tillë është duke ndodhur edhe me Ariun e Murrmë dhe ujkun e këtyre viseve. Organizata joqeveritare "Shoqëria Ballkanike për Mbrojtjen e Natyrës" është duke bërë një punë të madhe në mbrojtjen dhe trajtimin adekuat të këtyre kafshëve të rralla. Në të njëjtën kohë në bashkëpunim me autoritetet qendrore të Bullgarisë janë duke i hartuar politikat me të cilat rregullohet veprimtaria e organizatave të gjuetisë të cilat në të shumtën e rasteve kanë qenë shkaktarë të kësaj gjendjeje.



Kafshët e përmendura konsiderohen si resurs i rëndësishëm dhe pjesë integrale e kulturës dhe e zakoneve të kësaj ane, në të njëjtën kohë trajtimi adekuat i tyre do të ketë ndikim shtesë në kuadër të zhvillimit të turizmit në përgjithësi.

Këso projektesh janë shumë të mundshëm të implementohen edhe te ne me kafshët (Qeni i Sharrit etj.) dhe zakonet tona unike (kultivimi i Djathit të Sharrit etj.).

Mësimet e mësuara dhe mundësia e implementimit të tyre

- Menaxhimi i parqeve bëhet nga një trup gjë që do të duhej të funksionoj edhe tek ne;
- Me pak mjete materiale mund të arrihet rezultate të mëdha – kjo u pa sidomos në rregullimin e shenjzimeve të parkut e cila gjë tek ne pothuaj se nuk ekziston;
- Në Parkun Vitosha ishte e rregulluar mirë qendra informative në të cilën mund të merreshin të gjitha informacionet e nevojshme dhe mund të shiheshin ekzemplarë të ndryshëm nga territori i parkut. Kjo gjithashtu me shumë lehtësi mund të organizohet edhe në drejtorinë tonë të parkut.
- Projektet për trajtimin e kafshëve të egra, kafshëve unike si dhe kultivimin e zakoneve tradicionale, shembull i mirë të cilin do të mundohemi ta përfshijmë edhe në PH të Parkut Nacional "Mali Sharr";
- Ngritja e vetëdijes për mjedisin dhe angazhimi i strukturave për avancimin e saj, po ndikon në përmirësimin rrënjësor të gjendjes në mjedis.
- Besojmë se kjo vizitë është nismë e vazhdimit të një bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstytucional dhe shpresojmë në vizita të ngjashme në të ardhmen.